



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.715/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kadiu” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-58914-03-27-2018 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1 799 100 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 16.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.

Ankimues:

“Alstezo” shpk
Lagjia Kryengritja e Fierit, Rruga Aulona-Fier

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Rajonal Vlore
Lagja “Partizani”

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.03.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-58914-03-27-2018 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1 799 100 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 16.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.

II.2. Në datën 16.04.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 17.04.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | | |
|-------------|-----------|----------------|
| - Andi Hamo | pa ofertë | I skualifikuar |
| - Kadiu | 1,634,360 | I skualifikuar |

- Alstezo 1,772,850 I kualifikuar

II.4. Në datën 17.04.2018 operatori ekonomik “Kadiu” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *operatori ekonomik nuk ka vertetuar me dokumentate paraqitura qe pika e servisit e mare me qera permbush te gjitha kerkesat dhe kriteret e AK. Te gjitha faturat dokanore qe jane paraqitur nga operatori ekonomik tregojne pronesine e mjeteve por jo prezencen e tyre ne servisin e mar me qera.*

II.5. Në datën 24.04.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Dëshiroj tju kujtoj se ne si operator ekonomik me më shumë se 25 vjet eksperiencë në treg i kemi marrë shumë seriozisht kërkesat e paraqitura nga AK në DST e publikuar në faqen zyrtare të APP ku janë evidentuar me pika dhe shumë qartë kërkesat për tu plotësuar dhe i jemi përmbajtur me shumë rigorozitet atyre në plotësimin e dokumentacionit. Ndërkohë vërejmë se në refuzimin tuaj nuk ka asnjë referencë ose pikë ku ne të shohim se cila nga pikat nuk është plotësuar. I cuditshëm është fakti për distancën e kërkuar të servisit. Ndodh shpesh që institucione të tilla si spitalet ku emergjencat e punës dhe shërbimi ndaj pacientëve bën që servisi të kërkohet të jetë sa më pranë institucionit por në rastin tuaj servisi kërkohet jo brenda vlorës por 40 km larg fiks distanca ku ndodhet servisi i operatorit të kualifikuar. I kemi plotësuar kërkesat për dokumentacion dhe kemi të gjithë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të plotë të të gjitha kërkesave për riparimin e automjeteve.*

II.6. Në datën 24.04.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1727 prot i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 03.05.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi fazën në të cilën ndodhet procedura e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në datën 10.05.2018 ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit duke publikuar njëherazi “Njoftimin e Fituesit” në Sistemin e Prokurimeve Elektornike.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr.2019 prot datë 11.05.2018 protokolluar me tonën me nr.854/2 datë 16.05.2018 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit objekt ankimi.

II.10. Në datën 18.07.2018 Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Kadiu” shpk me vendimin KPP 467/2018 ka vendosur:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kadiu” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-58914-03-27-2018 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1 799 100 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 16.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Kadiu” shpk duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e datës 10.05.2018 për “Njoftim Fituesin”.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kadiu” shpk
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.11. Me shkresën Nr. 3519 Prot, datë 31.07.2018, protokolluar me tonën nr. 467/2 prot datë 02.08.2018, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, njofton se ka zbatuar vendimin K.P.P 467/2018 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-58914-03-27-2018 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1 799 100 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 16.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë dhe në datë 23.07.2018 autoriteti ka bërë rivlerësimin e ofertave në përputhje me konstatimet në vendim si më poshtë:

- Andi Hamo	pa ofertë	I skualifikuar
- Kadiu	1,634,360	I kualifikuar
- Alstezo	1,772,850	I kualifikuar

II.12. Në datën 03.08.2018 KPP me vendimin Nr. 467/3/2018 ka vendosur:

1. Të heqë pezullimin për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-58914-03-27-2018 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1 799 100 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 16.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.13. Në datën 25.07.2018, operatori ekonomik ankimues “Alstezo” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- Kundërshtojmë këtë riklasifikim sepse oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Kadiu sha është kualifikuar me pa të drejtë pasi nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit si më poshtë:

Në shtojcën 7 të DT pika 2.3 kapaciteti teknik kërkohet:

- 2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që ushtron aktivitet ekonomik që perkon me objektin e prokurimit. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Ekstrakt të Regjistrimit Tregtar për të Dhenat e Subjektit.

- 2.3.10 Duke patur parasysh natyrën e punës, për perballimin në kohë dhe me cilësi të riparimit dhe mirëmbajtjes në gjendje teknike të automjeteve të Spitalit Rajonal VLORE, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një pikë servisi për automjetet në një distancë jo më shumë se 40 km nga vendndodhja Autoriteti Kontraktor, ndërkohe që gjitha shpenzimet për transportin e mjeteve nga AK në servis do të perballohen nga ofertuesi.

Lidhur me këto kriteret konkretisht pika 2.3.2 duke ju referuar Ekstraktit Historik për të dhënat e subjektit deri në datën e zhvillimit të procedurës (për të mos thënë deri më sot), ky operator nuk rezulton të ketë aktivitet lidhur me riparimin e automjeteve në përputhje me kriteret e kërkuara në KVK, pra nuk ka aktivitet servis automjeteve në një distancë jo më shumë se 40 km nga vendndodhja e AK.

Më konkretisht nga informacioni i dhënë nga KPP në vendimin Nr.467/2018 datë 18.07.2018 lidhur me plotësimin e këtij kriteri ka rezultuar që ky OE ka përdorur në këtë procedurë një kontratë qeraje lidhur me subjektin Eltjkon Mema me nr.531 Rep Nr.118/1 Kol datë 25.02.2017 e cila së pari duket qartë që kemi të bëjmë me një lidhje të një kontrate me një subjekt që nuk ka në pronësi ose me qera një servis për ushtrim aktiviteti për riparim automjeteve por sikurse shprehet në kontratë qeradhënësi ka vetëm pajisje për autoriparimin të cilat do të japë me qera.

Së dyti nuk kemi të bëjmë me marrje me qera të një ambjenti servis për ushtrim të aktivitetit për riparim të automjeteve por vetëm pajisjet.

Së treti edhe nëse bëhet fjalë për pajisjet e autoriparimit në kontratë nuk është shprehur qartë nëse këto pajisje i ka marrë apo do të marrë në të ardhmen (e papërcaktuar kur në pikën 3.1 thuhet që efekti ligjor i kësaj kontrate fillon më 03.12.2016. Kjo kontratë është fiktive.

Sa më sipër kriteret e vendosura nga AK në KVK kapaciteti teknik pika 2.3.2 dhe 2.3.10 nuk plotësohen.

- Në pikën 2.3.3 të DT parashikohet :

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një personel teknik ,jo më pak se 8 (tete),(stafit teknik) të nevojshëm për realizimin e kontrates, pjesë e të cilit duhet të jenë :

1(nje) inxhinierë mekanikë

1(nje) motorristë

1(nje) xhenerikë

1 (nje) gomist

1 (nje) saldator

1 (nje) elektroaut

1(nje) diagnostikues difektesh mekanike

1(nje) diagnostikues difektesh elektrike dhe elektronike

Ne lidhje me kete pike ofertuesi duhet te paraqese,si vijon:

a-Vertetim nga dega e tatim taksave per pagesen e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te shoqeruara me listpagesat(formularet E-sig 025 a)per periudhen Nentor 2017-Shkurt 2018.

b-Diplomen(origjinale ose kopje te noterizuar)dhe kontraten e punes konform akteve ligjore ,per inxhinjer mekanik. Kontrata e punes duhet te kete nje afat vlefshmerie per te gjithë periudhen objekt kontrate/prokurimi.

c-Per personelin tjeter teknik ofertuesi duhet te paraqese deshmite perkatese profesionale te kualifikimit si dhe kontraten e punes respektive konform akteve ligjore. Afati i vlefshmerise se kontratave te punes, duhet te jete detyrimisht per te gjithë periudhen objekt kontrate/prokurimi.

Në lidhje me këtë kriter nga informacionet që kemi rezultojn që operatori ekonomik kadiu sha nuk ka dëshmi të kualifikimit për personelin teknik me profesionet sa më sipër sikurse kërkohet në KVK në DT.

Public Health Sector

- Në pikën 2.3.4 dhe 2.3.8 të DT parashikohet:

Operatori ekonomik ofertues,duhet te provoje se disponon License per ushtrimin e veprimtarise, leshuar nga QKB,referuar Kodit VII.3.B.1, kategorite a,b,c,ç

Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje leje mjedisore tipi C (III.1.A) per riparimin e pajisjeve motorike.

Në lidhje me këto kriterë në bazë edhe të argumenteve të mësipërme rezultojn që OE Kadiu nuk ka Licencë për ushtrimin e veprimtarisë lëshuar nga QKB referuar Kodit VII.3.B.1 kategoritë a,b,c,ç si dhe leje mjedisore tipi C (II.1.A) për riparimin e pajisjeve motorike në adresën sikurse kërkohet nga AK në shtojcën 7 KVK të DT në pikën 2.3.10. Ky operator ekonomik i ka licencat e mësipërme vetëm në adresën e ushtrimit të aktivitetit në Tiranë.

- Në pikën 2.3.5 të DT parashikohet:

Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, si vijon:

- 4 (kater) ura ngritese per furgonat (me krah te gjate) me kapacitet jo me pak se 4ton
- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit
- Linje kontrolli teknik te paisur me ure perkatese per ngritje dhe kontroll te mjetit
- Paisje per kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit te automjetit
- Paisje per kontrollin dhe testimin e sistemit amortizimit & vibrimeve te automjetit.
- Paisje per kontrollin dhe testimin e difekteve (xhokove) ne sistemin e drejtimit.
- Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotave se automjetit.
- Paisje per kontrollin & balancimin e disqeve & gomave automjetit (ballancimi rrotave).
- pajisje te levizshme (portabile) per ndezje emergjente te mjetit 12v & 24v.
- Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergences) rrotave te mjetit te kompletuara perkatesisht me urat me kater kollona te pershtatshme ne kapacitet per fuoristradat dhe furgonat sipas listes automjeteve referuar specifikimeve ne DT.
- Paisje per nderrimin e fluidit (alkoolit) per komplet sistemin e frenimit.
- Paisje per venien ne faze te motorrit te mjetit.
- Paisje per testimin e sistemit te ftohjes motorrit.
- Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C

Ne lidhje me kete kriter (pika 2.3.6) operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- Dokumenta qe vertetojne se keto paisje i ka ne pronesi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit, faturat e blerjes te jene te shoqeruar me dokumentin e çdoganimit te tyre ne emer te shoqerise) ose te marra me kontrate me qira .
- Foto te ambjenteve te autoservisit ne te cilin te jen te montuara pajisjet e sipershenuara, te cilat do te verifikohen nga AK perpara klasifikimit te ofertave

Në lidhje me këtë kriter rezulton që operatori ekonomik Kadiu sha realizon ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit vetëm për adresën në Tiranë por jo në adresën sikurse kërkohet nga AK në shtojcën 7 KVK të DT në pikën 2.3.10.

Përfundimisht kërkohet që të merren edhe një herë në konsideratë mangësitë e mësipërme të cilat janë të pakentostueshme dhe mbi këtë bazë kërkohet riklasifikimin e ofertave nga ana e KVO-së për këtë procedurë prokurimi duke bërë skualifikimin e operatorit ekonomik Kadiu sha.

II.14. Në datën 30.07.2018 me shkresën nr. 3502 prot operatori ekonomik ankimues “Alstezo” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.15. Në datën 03.08.2018, pala ankimuese “Alstezo” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.16. Nëpërmjet shkresës nr.3812 prot, datë 09.08.2018 prot me tonën me nr.1355 prot datë 13.08.2018, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Kadiu” shpk me arsyetimin se “Në shtojcën 7 të DT pika 2.3 kapaciteti teknik kërkohet:

- 2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që ushtron aktivitet ekonomik që perkon me objektin e prokurimit. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Ekstrakt të Regjistrimit Tregtar për të Dhenat e Subjektit.

- 2.3.10 Duke patur parasysh natyrën e punës, për perballimin në kohe dhe me cilësi të riparimit dhe mirëmbajtjes në gjendje teknike të automjeteve të Spitalit Rajonal VLORE, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një pikë servisi për automjetet në një distancë jo më shumë se 40 km nga vendndodhja Autoriteti Kontraktor, nderkohe që gjitha shpenzimet për transportin e mjeteve nga AK në servis do të perballohen nga ofertuesi.

Lidhur me këto kritere konkretisht pika 2.3.2 duke ju referuar Ekstraktit Historik për të dhënat e subjektit deri në datën e zhvillimit të procedurës (për të mos thënë deri më sot), ky operator nuk rezulton të ketë aktivitet lidhur me riparimin e automjeteve në përputhje me kriteret e kërkuara në KVK, pra nuk ka aktivitet servis automjeteve në një distancë jo më shumë se 40 km nga vendndodhja e AK.

Më konkretisht nga informacioni i dhënë nga KPP në vendimin Nr.467/2018 datë 18.07.2018 lidhur me plotësimin e këtij kriteri ka rezultuar që ky OE ka përdorur në këtë procedurë një kontratë qeraje lidhur me subjektin Eltjkon Mema me nr.531 Rep Nr.118/1 Kol datë 25.02.2017 e cila së pari duket qartë që kemi të bëjmë me një lidhje të një kontrate me një subjekt që nuk ka në pronësi ose me qera një servis për ushtrim aktiviteti për riparim automjeteve por sikurse shprehet në kontratë qeradhënësi ka vetëm pajisje për autoriparimin të cilat do ti japë me qera.

Së dyti nuk kemi të bëjmë me marrje me qera të një ambjenti servis për ushtrim të aktivitetit për riparim të automjeteve por vetëm pajisjet.

Së treti edhe nëse bëhet fjalë për pajisjet e autoriparimit në kontratë nuk është shprehur qartë nëse këto pajisje i ka marrë apo do ti marrë në të ardhmen (e papërcaktuar kur në pikën 3.1 thuhet që efekti ligjor i kësaj kontrate fillon më 03.12.2016. Kjo kontratë është fiktive.

Sa më sipër kriteret e vendosura nga AK në KVK kapaciteti teknik pika 2.3.2 dhe 2.3.10 nuk plotësohen”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” të publikuar nga autoriteti kontraktor me datë 03.04.2018 modifikohet kriteri si më poshtë:

ISHTE

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që ushtron aktivitet ekonomik që perkon me objektin e prokurimit. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:*

Ekstrakt të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit.

BËHET

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që ushtron aktivitet ekonomik që perkon me objektin e prokurimit. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:*

Ekstrakt të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit.

ISHTE

2.10

2.10.1 *Operatori ekonomik duhet të ketë një pikë shërbimi në territorin ku Autoriteti Kontraktor ushtron aktivitetin e tij. (Vertetuar me certifikatë pronësie ose qeraje).*



BËHET

2.3.10 *Duke patur parasysh natyrën e punës, për perballimin në kohë dhe me çilesi të riparimit dhe mirëmbajtjes në gjendje teknike të automjeteve të Spitalit Rajonal VLORE, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një pikë servisi për automjetet në një distancë jo më shumë se 40 km nga vendndodhja Autoriteti Kontraktor, nderkohe që gjitha shpenzimet për transportin e mjeteve nga AK në servis do të perballohen nga ofertuesi.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojnë se operatori ekonomik Kadiu sha në përmbushje të kriterëve sa më lart ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakt të regjistrimit tregëtar për të dhënat e subjektit nga ku rezultojnë se Kadiu sha ka zëyrë qendrore të shoqërisë në adresën Autostrada Tiranë –Durrës ndërsa në seksionin 28 Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit rezultojnë vendet , Lushnjë Elbasan, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Berat, Vlorë, Kukës

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e

prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.1.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Public Health Sector

III.1.6. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se Lidhur me këto kriteret konkretisht pika 2.3.2 duke ju referuar Ekstraktit Historik për të dhënat e subjektit deri në datën e zhvillimit të procedurës (për të mos thënë deri më sot), ky operator nuk rezulton të ketë aktivitet lidhur me riparimin e automjeteve në përputhje me kriteret e kërkuara në KVK , pra nuk ka aktivitet servis automjeteve në një distancë jo më shumë se 40 km nga vendodhja e AK, KPP gjykon se ankimuesi pa të drejtë ka ndërthurur dy kriteret të cilat qëndrojnë më vete dhe nuk kanë aspak lidhje me njëra tjetrën. Konkretisht kriteri i parashikuar në pikën 2.3.2 të kriterëve kualifikuesë kërkon që operatorët ekonomikë të ushtrojnë aktivitet ekonomik që perkon me objektin e prokurimit dhe në lidhje me kete pike të paraqesin Ekstrakt të Regjistrimit Tregtar për të Dhenat e Subjektit. Nga verifikimi i objektit të veprimtarisë të subjektit Kadiu në ekstraktin e regjistrimit tregëtar rezulton se ndër të tjera Kadiu sha ka për objekt të veprimtarisë së tij edhe servis për riparim të automjeteve të të gjitha llojeve dhe të tipeve të ndryshme duke përfshirë autovetura dhe makina të cdo tonazhi. Në këtë kuptim KPP gjykon se Kadiu sha e plotëson kriterin e parashikuar në pikën 2.3.2 të kriterëve kualifikuesë sa i takon ushtrimin të veprimtarisë që perkon me objektin e prokurimit vërtetuar kjo me anë të ekstraktit të regjistrimit të subjektit që pasqyron objektin e veprimtarisë.

Ndërkohë lidhur me kriterin tjetër të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi në pikën 2.3.10 i cili parashikon se ”Duke patur parasysh natyrën e punes, per perballimin ne

kohe dhe me cilesi te riparimit dhe mirembajtjes ne gjendje teknike te automjeteve te Spitalit Rajonal VLORE, operatori ekonomik ofertues duhet te kete nje pike servisi per automjetet ne nje distance jo me shume se 40 km nga vendndodhja Autoriteti Kontraktor, nderkohe qe gjitha shpenzimet per transportin e mjeteve nga AK ne servis do te perballohen nga ofertuesi”, KPP referuar ekstraktit të regjistrimit tregëtar konstaton se operatori ekonomik ”Kadiu” sha ushtron aktivitet në disa qytete të shqipërisë ndër to edhe në qytetin e Vlorës. Në kushtet kur kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar një dokument konkret për përmbushjen e tij lidhur me nje pike servisi per automjetet ne nje distance jo me shume se 40 km nga vendndodhja Autoriteti Kontraktor, KPP gjykon se ky fakt vërtetohet nëpërmjet ekstraktit të shoqërisë se subjekti ”Kadiu” ushtron aktivitet në këtë qytet.

Sa më sipër pretendimet e ankimesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Alstezo” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Kadiu” shpk me arsyetimin se: *Në pikën 2.3.3 të DT parashikohet : Operatori ekonomik ofertues duhet te kete nje personel teknik ,jo me pake se 8 (tete),(stafit teknik) te nevojshem per realizimin e kontrates, pjese e te cilit duhet te jene :*

1(nje) inxhinierë mekanikë; 1(nje) motorristë; 1(nje) xhenerikë; 1 (nje) gomist; 1 (nje) saldator; 1 (nje) elektroaut ; 1(nje) diagnostikues difektsh mekanike ; 1(nje) diagnostikues difektsh elektrike dhe elektronike. Ne lidhje me kete pike ofertuesi duhet te paraqese,si vijon:

a-Vertetim nga dega e tatim taksave per pagesen e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te shoqeruara me listpagesat(formulet E-sig 025 a)per periudhen Nentor 2017-Shkurt 2018.

b-Diplomen(origjinale ose kopje te noterizuar)dhe kontraten e punes konform akteve ligjore ,per inxhinjer mekanik. Kontrata e punes duhet te kete nje afat vlefshmerie per te gjithe periudhen objekt kontrate/prokurimi.

c-Per personelin tjeter teknik ofertuesi duhet te paraqese deshmitë perkatese profesionale te kualifikimit si dhe kontraten e punes respektive konform akteve ligjore. Afati i vlefshmerise se kontratave te punes, duhet te jete detyrimisht per te gjithe periudhen objekt kontrate/ prokurimi.

Në lidhje me këtë kriter nga informacionet që kemi rezultojn që operatori ekonomik kadiu sha nuk ka dëshmi të kualifikimit për personelin teknik me profesionet sa më sipër sikurse kërkohet në KVK në DT.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” të publikuar nga autoriteti kontraktor me datë 03.04.2018 modifikohet kriteri si më poshtë:

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete nje personel teknik ,jo me pake se 8 (tete),(stafit teknik) te nevojshem per realizimin e kontrates, pjese e te cilit duhet te jene :

1(nje) inxhinierë mekanikë

1(nje) motorristë

1(nje) xhenerikë

1 (nje) gomist

1 (nje) saldator

1 (nje) elektroaut

1(nje) diagnostikues difektesh mekanike

1(nje) diagnostikues difektesh elektrike dhe elektronike

Ne lidhje me kete pike ofertuesi duhet te paraqese,si vijon:

a-Vertetim nga dega e tatim taksave per pagesen e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te shoqeruara me listpagesat(formularet E-sig 025 a)per periudhen Nentor 2017-Shkurt 2018.

b-Diplomen(origjinale ose kopje te noterizuar)dhe kontraten e punes konform akteve ligjore,per inxhinjer mekanik.Kontrata e punes duhet te kete nje afat vlefshmerie per te gjithë periudhen objekt kontrate/prokurimi.

c-Per personelin tjeter teknik ofertuesi duhet te paraqese deshmitë perkatese profesionale te kualifikimit si dhe kontraten e punes respektive konform akteve ligjore. Afati i vlefshmerise se kontratave te punes,duhet te jete detyrimisht per te gjithë periudhen objekt kontrate/ prokurimi.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik Kadiu sha në përmbushje të kriterit sa më lart ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë Punonjësish me përmbajtje si vijon:
- M.Zh–Ing Mekanik-Drejtues Teknik+dëshmi aftësie profesionale e drejtuesit teknik.
- E.Xh-motorist+dëshmi aftësie profesionale
- A.O-salator+dëshmi të aftësisë profesionale
- L.M-gomist+dëshmi të aftësisë profesionale
- E. B-xhenerik+ dëshmi të aftësisë profesionale
- S.A-elektrot+dëshmi të aftësisë profesionale
- K. T-inxhinier megatronik (diagnostikues elektrike dhe elektronike)+dëshmi profesionale)
- G.A-inxhinier mekanik (diagnostikues mekanike)+dëshmi

Të gjithë punonjësit e sipërpërmendur janë të pajisur me diploma apo dëshmi të kualifikimit profesional.

- Dëshmi Aftësie Profesionale për punonjësën K.T+diplomë
- Dëshmi Aftësie Profesionale për punonjësën G.A+diplomë
- Dëshmi Aftësie Profesionale për punonjësën M.Zh-diplomë
- Diplomë+certifikatë për punonjësën A.O

- Certifikatë për punonjësin E. Xh
- Diplomë për punonjësin L. M
- Certifikatë për punonjësin S. A
- Diplomë për punonjësin E. B

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

III.2.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.2.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

- a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- c) *dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.2.6. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e kualifikimit është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë *per personelin tjetër teknik deshmitë perkatëse profesionale te kualifikimit si dhe kontratën e punës respektive konform akteve ligjore.* Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër KPP vëren se operatori ekonomik Kadiu sha ka dorëzuar për të gjithë punonjësit e sipërcituar sipas profileve të kërkuara certifikatat përkatëse profesionale si dhe kontratat e punës.

Sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik “Kadiu” sha ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Kadiu” shpk me arsyetimin se: *Në pikën 2.3.4 dhe 2.3.8 të DT parashikohet: Operatori ekonomik ofertues, duhet të provojë se disponon License per ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1, kategorite a,b,c,ç . Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë leje mjedisore tipi C (III.1.A) për riparimin e pajisjeve motorike. Në lidhje me këto kritere në bazë edhe të argumenteve të mësipërme rezulton që OE Kadiu nuk ka Licencë për ushtrimin e veprimtarisë lëshuar nga QKB referuar Kodit VII.3.B.1 kategoritë a,b,c,ç si dhe leje mjedisore tipi C (III.1.A) për riparimin e pajisjeve motorike në adresën sikurse kërkohet nga AK në shtojcën 7 KVK të DT në pikën 2.3.10. Ky operator ekonomik i ka licencat e mësipërme vetëm në adresën e ushtrimit të aktivitetit në Tiranë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” të publikuar nga autoriteti kontraktor me datë 03.04.2018 modifikohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori ekonomik ofertues, duhet të provojë se disponon License per ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1, kategorite a,b,c,ç*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë leje mjedisore tipi C (III.1.A) për riparimin e pajisjeve motorike.*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Kadiu” sha në përmbushje të kriterit sa më lart ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Licencë Kodi VII.3.B.1 –a) Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit , të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, b) Riparim dhe mirëmbajtje e karrocërisë të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove , c) Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ç) Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.
- Leje Mjedisore Kodi III.1.A subjktit Kadiu Për ndikim në Mjedis : Leje Mjedisore e tipit C për aktivitetin: Riparim i pajisjeve motorike dhe moocikletave.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

III.3.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.3.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*

c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.3.6. Edhe në këtë rast ankimuesi ka ndërthur kriteret të cilat qëndrojnë më vete dhe nuk kanë lidhje me njëra tjetrën . Argumenti i ankimuesit se operatori ekonomik “Kadiu” sha nuk ka licencë për ushtrimin e veprimtarisë lëshuar nga QKB referuar Kodit VII.3.B.1 kategoritë a,b,c,ç si dhe leje mjedisore tipi C (II.1.A) për riparimin e pajisjeve motorike në adresën sikurse kërkohet nga AK në shtojcën 7 KVK të DT në pikën 2.3.10. Ky operator ekonomik i ka licencat e mësipërme vetëm në adresën e ushtrimit të aktivitetit në Tiranë”, është tërësisht i pabazuar. KPP gjykon se Licencat e sipërcituara jepen në përputhje me objektin e veprimtarisë dhe jo me vendodhjen e ushtrimit të aktivitetit. KPP gjykon se operatori ekonomik “Kadiu” ka përmbushur kriteret kualifikuese të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi si për sa i përket licencës për ushtrimin e veprimtarisë lëshuar nga QKB referuar Kodit VII.3.B.1 kategoritë a,b,c,ç si dhe leje mjedisore tipi C (II.1.A) për riparimin e pajisjeve motorike.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.4. . Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Kadiu” shpk me arsyetimin se: *Në pikën 2.3.5 të DT parashikohet: Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, si vijon:*

- *4 (kater) ura ngritese per furgonat (me krah te gjate) me kapacitet jo me pak se 4ton*
- *Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit*
- *Linje kontrolli teknik te paisur me ure perkatese per ngritje dhe kontroll te mjetit*
- *Paisje per kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit te automjetit*
- *Paisje per kontrollin dhe testimin e sistemit amortizimit & vibrimeve te automjetit.*
- *Paisje per kontrollin dhe testimin e difekteve (xhokove) ne sistemin e drejtimit.*
- *Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit.*

- *Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave).*
- *pajisje te levizshme (portabile) per ndezje emergjente te mjetit 12v & 24v.*
- *Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergences) rrotave te mjetit te kompletuara perkatesisht me urat me kater kollona te pershtatshme ne kapacitet per fuoristradat dhe furgonat sipas listes automjeteve referuar specifikimeve ne DT.*
- *Paisje per nderrimin e fluidit (alkoolit) per komplet sistemin e frenimit.*
- *Paisje per venien ne faze te motorrit te mjetit.*
- *Paisje per testimin e sistemit te ftohjes motorrit.*
- *Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C*

Ne lidhje me kete kriter (pika 2.3.6) operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- *Dokumenta qe vertetojne se keto paisje i ka ne pronesi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit, faturat e blerjes te jene te shoqeruar me dokumentin e çdoganimit te tyre ne emer te shoqerise) ose te marra me kontrate me qira .*
- *Foto te ambjenteve te autoservisit ne te cilin te jen te montuara pajisjet e sipershenuara, te cilat do te verifikohen nga AK perpara klasifikimit te ofertave*

Në lidhje me këtë kriter rezulton që operatori ekonomik Kadiu sha realizon ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit vetëm për adresën në Tiranë por jo në adresën sikurse kërkohet nga AK në shtojcën 7 KVK të DT në pikën 2.3.10, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

Me vendimin KPP 467/2018 datë 18.07.2018 Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur lidhur me përmbushjen e kriterit të sipërcituar nga operatori ekonomik Kadiu sha. Në këtë vendim KPP ka arsyetuar se se operatori ekonomik Kadiu sha me dokumentacionin e paraqitur plotëson kriterin e kualifikimit të sipërcituar lidhur me mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga autoriteti kontraktor duke analizuar dhe shqyrtuar të gjitha kërkesat e kriterit të kualifikimit.

Në këtë kuptim, këto pretendime marrin cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo, analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar dhe për rrjedhim, *ipso lege*, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim.

Fuqia e “gjësë së gjykuar” mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit administrativ perfundimtar, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në shqyrtim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese, dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron organi administrativ në dispozitivin e vendimit të tij.

Sa më sipër pretendimet e ankimesit nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-58914-03-27-2018 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1 799 100 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 16.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1355 Protokolli ; Datë 03.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar ————— **Anëtar** ————— **Anëtar** ————— **Anëtar**
Enkeleda Bega ————— **Vilma Zhupaj** ————— **Lindita Skeja** ————— **Merita Zeqaj**

